



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik “NSHT Victory Com” të datës 09.06.2025 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i parkut rekreativ dhe hapësirave gjelbëruese në rrugën Muharrem Fejza” me nr. të prokurimit 616-25-1686-5-2-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHE**t kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “NSHT Victory Com” të datës 09.06.2025 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i parkut rekreativ dhe hapësirave gjelbëruese në rrugën Muharrem Fejza” me nr. të prokurimit 616-25-1686-5-2-1.
- II. **AUTORIZOHE**t autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHE**n palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik “NSHT Victory Com” (tutje “parashtruesi”) me datë 09.06.2025 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i parkut rekreativ dhe hapësirave gjelbëruese në rrugën Muharrem Fejza” me nr. të prokurimit 616-25-1686-5-2-1.

Pretendimet ankimore të parashtruesit:

nga grupi si tërësi. Pa varësisht nga kjo, në rast se të gjithë anëtarët e grupit marrin pjesë në ekzekutimin e kontratës duke liferuar furnizime të prodhuara nga vetë ato, atëherë të gjithë anëtarët e grupit duhet të jenë të pajisur me certifikata të tilla, në mënyrë që AK të sigurohet se produktet e furnizuara janë të cilësisë sipas standardeve përkatëse të specifikuara në dokumentet e tenderit.

Gjithashtu Certifikatat e paraqitura në gjuhën turke janë të pa lexueshme dhe në bazë të ligjeve të Republikës së Kosovës dokumentet në gjuhën Turke nuk janë të pranueshme.

Gjithashtu Mungon Makineria nr 7 OE ka paraqitur një Sharr kurse kërkesa e AK ka qenë Makin për prerjen e elementeve betonit e cila është ndryshe prej kësaj që ka paraqitur ky OE Lloji I (tipi) makineris në fjalë është Statike dhe bene prerjen e elementeve betonit në qdo formë.

Në Bazë të këtij interpretimi ky GOE duhet diskualifikuar nga kjo ofertë.

Kërkesë për rishqyrtim për OE AAB Construction

Lista e pasiveve të OE AAB nuk është përmbushur sipas dosjes së tenderit pasi që në Listën e Makineris duhet cekur sipas dosjes

Të dhënat për pajisjet (viti i prodhimit, gjendja e pajisjes, kamiona rexi, i targave, mekanizmi, dëshmitë mbi pronësinë ose kontratë për huazim,etj)

Lidhur me pretendimet ankimore fillimisht duhet sqaruar se OE ankues ka ofertuar me 171,085.00 euro ndërsa tenderuesi i rekomanduar për kontratë ka ofertuar me 88,190.00 euro. Me fjalë të tjera OE ankues ka ofertuar 51.55% më shtrenjtë sesa OE fitues.

Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit lidhur me tenderuesin e rekomanduar është gjetur se oferta e dorëzuar është në përputhje të plotë me të gjitha kërkesat e DT si dhe specifikat teknike të DT. Tenderuesi i rekomanduar ka dorëzuar ISO Standardet sipas kërkesave të DT. Po ashtu certifikatat e dorëzuara në gjuhë të huaja janë dorëzuar edhe në versionin e përkthyer në gjuhën angleze e cila është gjuhë e pranueshme sipas LPP (po ashtu edhe të noterizuara). Po ashtu është prezantuar edhe makina për prerjen e betonit. Pra të gjitha pretendimet ankimore të parashtruesit janë të pabazuara.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi. Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 11.06.2025

Visar SHEHU



Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.